- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikime Teknike

Objekti

Furnizim, instalim, konfigurim, testim dhe vënie në punë e pajisjeve audio-vizive për Sallën Multifunktionale, Gramsh, për përdorim në aktivitete kulturore, shfaqje kinematografike, prezantime, konferenca dhe veprimtari skenike. Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e kërkesave funksionale dhe minimale të performancës, në përputhje me parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive, sipas legjislacionit të prokurimit publik dhe dokumenteve standarde të tenderit.

Të gjitha referencat ndaj standardeve, klasave, certifikimeve, teknologjive ose karakteristikave teknike duhet të interpretohen si kërkesa minimale, ku pranohen edhe produkte ose zgjidhje ekuivalente, me kusht që operatori ekonomik të provojë me dokumentacion teknik zyrtar, katalogë, certifikata, deklaratat konformiteti ose raporte testimi se produkti i ofertuar përmbush në mënyrë të barasvlershme kërkesat funksionale, të sigurisë dhe të performancës.

Specifikime Teknike për Video Projektorin

Kërkesa të përgjithshme

Video projektori duhet të jetë i tipit profesional për instalim fiks në sallë multifunktionale, i përshtatshëm për përdorim në ambiente publike me ekran të madh dhe me mundësi përdorimi për përmbajtje filmike, prezantime dhe aktivitete kulturore. Pajisja duhet të jetë e re, jo e përdorur, dhe të ofrohet me të gjithë aksesoret e nevojshëm për funksionim normal, montim dhe integrim në sistemin audio-viziv të sallës.

Parametrat minimalë teknikë

- Ndriçimi minimal: 13,000 ANSI lumens.
- Teknologjia e projektimit: 3LCD ose ekuivalente, e përshtatshme për instalim profesional.
- Burimi i dritës: Laser.
- Rezolucioni natyral: WUXGA (1920 x 1200) ose më i lartë.
- Pajisja duhet të mbështesë përmbajtje me raport figure 16:9, të përshtatshme për përdorim kinematografik, edhe nëse rezolucioni natyral i projektorit është WUXGA.
- Projektori duhet të jetë i përshtatshëm për montim front / rear / ceiling, sipas konfigurimit të sallës.
- Distanca e instalimit duhet të jetë e përputhshme me kushtet reale të sallës, me mundësi vendosjeje në intervalin afërsisht 10 m deri në 14 m nga sipërfaqja e projeksionit, për perde me gjerësi aktive 6.0 m. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin zgjidhjen përkatëse të lentës ose konfigurimit optik që garanton mbulimin korrekt të ekranit në këtë distancë.

-
- Projektori duhet të ketë zoom optik dhe lens shift vertikal dhe/ose horizontal, për të mundësuar instalim korrekt pa deformime të papranueshme të figurës.
 - Projektori duhet të pranojë të paktën sinjale hyrëse video: 720p, 1080i, 1080p, 3840 x 2160 dhe 4096 x 2160 ose ekuivalente.
 - Niveli i zhurmës operative duhet të jetë i përshtatshëm për sallë publike dhe përdorim kinematografik.
 - Furnizimi me energji elektrike duhet të jetë i përshtatshëm për rrjetin europian: 100–240 V, 50/60 Hz.

Hyrje/Dalje minimale

Projektori duhet të ketë minimalisht këto porta ose ekuivalente funksionale:

- HDMI: minimumi 1 portë;
- HDBaseT: minimumi 1 portë;
- DVI-D ose ekuivalente: minimumi 1 portë;
- VGA ose ekuivalente: minimumi 1 portë;
- RJ-45 Network: minimumi 1 portë;
- RS-232C: minimumi 1 portë;
- USB Type A dhe/ose USB Type B sipas arkitekturës së prodhuesit;
- dalje audio ose option ekuivalent kontrolli/sinjali, sipas modelit të ofertuar.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun zyrtar ose datasheet-in e prodhuesit, ku të provohen qartë parametrat e mësipërm, si dhe të specifikojë modelin e lentës së ofruar kur ajo është e ndashme ose e zëvendësueshme. Në rastet kur projektohet përdorimi i një lenteje të veçantë, duhet të paraqitet dokumentacioni teknik që vërteton përputhshmërinë e saj me distancën reale të instalimit dhe dimensionet e ekranit.

Specifikime Teknike për Perden e Projeksionit

Kërkesa funksionale

Perdja e projeksionit duhet të jetë e përshtatshme për përdorim në sallë multifunksionale, si për shfaqje kinematografike, ashtu edhe për aktivitete kulturore dhe përdorim skenik.

Parametrat minimalë teknikë

- Dimensionet aktive të perdes: 6.0 m gjerësi x 4.0 m lartësi.

- Perdja duhet të ketë sistem tensionimi anësor kundër valëvitjeve, me qëllim ruajtjen e një sipërfaqeje sa më të sheshtë dhe të qëndrueshme gjatë përdorimit.
- Perdja duhet të jetë e përshtatshme minimalisht për front projection; nëse operatori ekonomik ofron material të përshtatshëm edhe për rear projection, kjo mund të pranohet si vlerë e shtuar, pa qenë kërkesë detyruese.
- Materiali duhet të jetë i qëndrueshëm, i përshtatshëm për ambient publik dhe për përdorim të shpeshtë.
- Materiali duhet të jetë rezistent ndaj flakës dhe i certifikuar sipas standardit EN 13501-1 dhe sipas standardit kombëtar ekuivalent të njerit prej vendeve të BE. Qëllimi i kësaj kërkesë është ofrimi i një produkti certifikimi i të cilit garanton në mënyrë sa më optimale rezistencën ndaj zjarrit nisur dhe nga ambienti në të cilin ky produkt do të përdoret.
- Montimi duhet të jetë i përshtatshëm për tavan ose strukturë mbajtëse të dedikuara, sipas zgjidhjes teknike të propozuar nga operatori ekonomik.
- Në ofertë duhet të përfshihen të gjithë aksesorët për montim, dhe vënien në punë.

Specifikime Teknike për Sistemin Audio

Kërkesa të përgjithshme

Sistemi i propozuar duhet të jetë një sistem audio profesional i integruar, i projektuar për instalime profesionale fikse dhe funksionim me besueshmëri të lartë. Sistemi audio duhet të jetë i përshtatshëm për sallë multifunksionale dhe të garantojë riprodhim të qartë të zërit për konferenca, aktivitete skenike, muzikë të regjistruar, fjalime dhe shfaqje filmike. Të gjitha pajisjet duhet të jenë të reja, të përputhshme ndërmjet tyre dhe të dimensionuara për funksionim si sistem i integruar.

Bokset, subwoofer-ët, amplifikatorët dhe DSP-kontrollerët duhet të jenë plotësisht kompatibël dhe të konfigurohen sipas rekomandimeve zyrtare të prodhuesit.

Ofertuesi duhet të paraqesë datasheet-et zyrtare të prodhuesit për të gjithë komponentët kryesorë të sistemit.

Parametrat e përgjigjes së frekuencës, Max SPL, impedancës dhe amplifikimit duhet të dokumentohen nëpërmjet dokumentacionit teknik zyrtar të prodhuesit.

Pranohen zgjidhje teknikisht ekuivalente ose më të mira që plotësojnë kërkesat minimale të mësipërme dhe garantojnë performancën akustike, kompatibilitetin, besueshmërinë dhe funksionimin e plotë të sistemit.

Boks pasiv profesional – Tipi 1

- Tipologjia: Boks pasiv profesional
- Përgjigja e frekuencës: Duhet të mbulojë të paktën 150 Hz–18 kHz ose interval më të gjerë
- Max SPL: Jo më pak se 116 dB peak
- Impedanca nominale: 8 Ω –64 Ω , fikse ose e përzgjedhshme sipas konfigurimit të prodhuesit
- Teknologjia akustike: Point Source, Line Source, Column Array ose teknologji profesionale ekuivalente
- Sistem profesional montimi dhe orientimi
- Konstruksion i përshtatshëm për instalim profesional
- Boksi duhet të jetë kompatibël me amplifikatorin/DSP-kontrollerin dhe preset-et, profilet ose konfigurimet e dedikuara të sistemit
- Kapaciteti i fuqisë: Sipas specifikimeve dhe rekomandimeve zyrtare të prodhuesit.

Boks pasiv profesional – Tipi 2

- Tipologjia: Boks pasiv profesional
- Përdorimi: Instalim profesional fiks
- Përgjigja e frekuencës: Duhet të mbulojë të paktën 150 Hz–18 kHz ose interval më të gjerë
- Max SPL: Jo më pak se 123 dB peak
- Impedanca nominale: 4 Ω –32 Ω , fikse ose e përzgjedhshme sipas konfigurimit të prodhuesit
- Teknologjia akustike: Point Source, Line Source, Column Array ose teknologji profesionale ekuivalente
- Konstruksion i përshtatshëm për instalim profesional
- Sistem profesional montimi dhe orientimi
- Boksi duhet të jetë kompatibël me amplifikatorin/DSP-kontrollerin dhe preset-et, profilet ose konfigurimet e dedikuara të sistemit
- Kapaciteti i fuqisë: Sipas specifikimeve dhe rekomandimeve zyrtare të prodhuesit

Subwoofer profesional – Tipi 3

- Tipologjia: Subwoofer profesional pasiv
- Transduktori LF: Minimumi 12" ose konfigurim ekuivalent më performant
- Frekuenca e poshtme e përdorshme: Jo më e lartë se 40 Hz
- Frekuenca e sipërme: Minimumi 100 Hz ose më e lartë, sipas preset-it/crossover-it të prodhuesit
- Max SPL: Jo më pak se 131 dB peak
- Impedanca nominale: 4 Ω –8 Ω ose konfigurim ekuivalent i miratuar nga prodhuesi
- Direktiviteti: Omnidireksional në konfigurim standard dhe/ose mundësi konfigurimi kardiod, sipas teknologjisë së prodhuesit
- Kapaciteti i fuqisë: Sipas dimensionimit dhe rekomandimeve zyrtare të prodhuesit
- Konstruksion profesional

- Kompatibilitet i plotë me amplifikatorin/DSP-kontrollerin dhe preset-et, profilet ose konfigurimet e dedikuara të subwoofer-it

Amplifikator / DSP-kontroller profesional

- Tipologjia: Amplifikator profesional shumëkanalësh me DSP të integruar
- Teknologjia e amplifikimit: Class D ose teknologji profesionale ekuivalente
- Numri i kanaleve të amplifikuara: Minimumi 4
- Fuqia dalëse: Minimumi $4 \times 640 \text{ W}$ në 4Ω ose konfigurim ekuivalent/më performant sipas arkitekturës së prodhuesit
- Përgjigja e frekuencës: Duhet të mbulojë të paktën 20 Hz–20 kHz
- DSP i integruar me funksione për menaxhimin dhe optimizimin e sistemit
- EQ parametrik
- Crossover/filtra
- Delay
- Limiter dhe/ose sistem i dedikuar për mbrojtjen e altoparlantëve
- Preset-e, profile ose konfigurime të dedikuara për bokset dhe subwooferët e ofruar
- Mbrojtje ndaj mbingarkesës, temperaturës së lartë, mbirrymës dhe qarkut të shkurtër
- Monitorim dhe diagnostikim të parametrave kryesorë të sistemit
- Mundësi konfigurimi dhe monitorimi nëpërmjet software-it profesional të prodhuesit, nëse sistemi e parashikon
- Amplifikatori/DSP-kontrolleri duhet të jetë i rekomanduar ose i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të altoparlantëve, ose duhet të dokumentohet kompatibiliteti i plotë teknik

Mikrofon valor

- Sistem wireless analog UHF për live dhe prezantime
- Frekuenca operative: minimumi 548 – 572 MHz
- Antena të integruara për stabilitet të lartë të sinjalit
- Mikrofon dinamik kardiod
- Përgjigja në frekuencë: minimumi 50 Hz – 16 kHz
- Deri në 10 kanale të pershatshem njëkohësisht
- Fuqia e transmetimit: minimumi 10 mW
- Distanca operative: deri në 70 – 75 metra në kushte line-of-sight
- Dalje audio: XLR balanced dhe Jack 6.3 mm
- Sinkronizim automatik ndërmjet transmetuesit dhe marrësit
- Skanim automatik për frekuenca të lira
- Autonomi deri në 10 orë
- Seti duhet të përmbajë: Marrësin; Mikrofonin valor me kapsulë dinamike kardioide; Kapësen e mikrofonit; pershatesin e baterise.

Mikrofon me kabell

- Mikrofon dinamik profesional për live dhe prezantime
- Karakteristikë polare: Superkardioid
- Përgjigja në frekuencë: minimumi 40 Hz – 16 kHz
- Impedanca nominale: minimumi 350 Ω
- SPL maksimal: mbi 150 dB
- Reduktim të zhurmave nga përdorimi
- Konektor XLR balanced
- Pesha maksimale 350 g
- Seti duhet të përmbajë: Mikrofonin dinamik; Kapësen e mikrofonit; Çantën mbrojtëse

Kërkesa të përgjithshme për audion

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një zgjidhje të integruar audio, me skemë lidhjeje, përputhshmëri të plotë ndërmjet bokseve, subwoofer-it, amplifikatorit dhe mikserit, si dhe me të gjithë aksesoret, kabllot, konektorët, mbajtëset dhe elementet e montimit të nevojshëm për funksionim të plotë. Nuk pranohen konfigurime ku parametrat teknikë të pajisjeve të ofertuara janë të papërputhshëm ndërmjet tyre.

Specifikime Teknike për Kamerën + mikser video

Kamera PTZ

Kamera duhet të jetë e përshtatshme për përdorim funksional sipas nevojës së sallës, me parametra minimalë si më poshtë:

- Kamera PTZ e përshtatshme për konferenca, auditore, evente dhe live streaming
- Sensor profesional CMOS minimumi 1/2.8" me rezolucion minimumi 2MP
- Rezolucion video minimumi Full HD 1920 × 1080p30 – 1080p60
- Zoom optik minimumi 12X – 18X
- Lentë profesionale me kënd horizontal minimumi 55° – 60°
- Fokus automatik dhe manual me kontroll PTZ profesional
- Dalje video: minimumi HDMI, USB 3.0 dhe IP Streaming
- Mbështetje për protokolle: RTSP, RTMP, ONVIF, VISCA over IP
- Lëvizje Pan/Tilt: Horizontal minimumi $\pm 160^\circ$ - Vertikal minimumi -25° deri $+85^\circ$
- Presete të programueshme për pozicione kamere
- Kontroll RS232 / RS485 / VISCA
- Reduktim zhurme dhe performancë optimale edhe në ndriçim të ulët

Mikser Video

- Mikser Video Profesional për Live Streaming i përshtatshëm për regjistrime eventesh
- Deri në 4 hyrje video HDMI me konvertim automatik formati
- Minimumi 1 dalje HDMI Program + 1 dalje USB webcam
- Minimumi 2 hyrje audio 3.5 mm stereo
- Ethernet 10/100/1000 për streaming dhe kontroll rrjeti
- USB-C për regjistrim direkt në media të jashtme dhe webcam output
- Standardet për hyrjet video HD 720p50 1080p23.98 - 1080p60 + 1080i50
- Standardet për dalje video HD 1080p23.98 deri 1080p60
- Regjistrim ISO për minimumi 4 hyrje video + Program Out
- Miksimi me minimumi - 1 Upstream Keyer+ 1 Downstream Keyer
- Sinjalet dhe parametrat audio për Mikser min 4 hyrje me nga 2 kanale, me kontroll individual gain, kompresor + limiter gate, hyrje analog / stereo
- Streaming direkt RTMP për rrjete sociale nepermjet Ethernet ose internet; 4 hyrje HDMI.
- Monitorim me disa pamje njëkohësisht me tregues për statusin e operacioneve video dhe audio.
- Panel kontrolli i integruar
- Kontroll përmes software në Windows dhe macOS

Instalimi, Konfigurimi, Testimi dhe Vënia në Punë e Sistemit

Operatori ekonomik fitues duhet të kryejë furnizimin, transportin, montimin, instalimin, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë të të gjithë sistemit audio-viziv. Oferta duhet të përfshijë të gjitha materialet ndihmëse, kabllot, mbajtëset, aksesoret, furnizimet elektrike, elementet e komandimit dhe çdo komponent tjetër të nevojshëm për funksionimin e plotë të sistemit.

Pas instalimit, operatori ekonomik duhet të kryejë testim funksional në ambientin real të përdorimit dhe të dorëzojë sistemin në gjendje pune. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë përputhshmërinë e pajisjeve me specifikimet teknike, përmes kontrollit dokumentar dhe testimit praktik në vend.

Dokumentacioni i Detyrueshëm i Operatorit Ekonomik

Operatori ekonomik duhet të paraqesë së paku:

-
- katalogët, broshurat ose datasheet-et zyrtare të prodhuesit për secilin produkt;
 - certifikatat ose deklaratat e konformitetit, kur aplikohen;
 - certifikatat kundër zjarrit për perden e projeksionit;
 - skemën e propozuar të instalimit dhe integritetit të sistemit;
 - listën e aksesorëve dhe komponentëve ndihmës që përfshihen në ofertë;
 - deklaram që pajisjet janë të reja, origjinale dhe jo të përdorura;
 - dokumentacionin e garancisë;

Garancia dhe Shërbimi Pas Shitjes

Të gjitha pajisjet duhet të ofrohen me garanci sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe kontratës. Operatori ekonomik duhet të sigurojë shërbim pas shitjes, asistencë teknike, si dhe zëvendësim ose riparim të pjesëve me defekt gjatë periudhës së garancisë, sipas kushteve të kontratës dhe dokumentacionit të ofertës.

Klauzolë për Ekuivalencën dhe Mosdiskriminimin

Çdo referencë e bërë në këto specifikime ndaj një standardi, teknologjie, klase, certifikimi, metode testimi ose karakteristike teknike duhet të lexohet gjithmonë e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalent”, përveç rasteve kur natyra e kërkesës e bën objektivist të pamundur një ekuivalencë të tillë. Barra e provës për ekuivalencën i takon operatorit ekonomik, i cili duhet ta provojë atë me dokumentacion teknik zyrtar dhe të verifikueshëm.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT
Sasia e mallit që kërkohet:

ANEKS 1 PREVENTIV PROJEKT ZBATIMI					
OBJEKTI: "SALLA MULTIFUNKSIONALE, GRAMSH"					
Nr.	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI /Lekë	VLEFTA / Lekë
	SISTEM VIDEO - PROJEKSIONI				
1	F.V.Workstation / Laptop	cope	1.0		
2	F.V. Videoprojektor profesional	cope	1.0		
3	F.V. Strukturë mbajtëse për Videoprojektor	cope	1.0		
4	F.V.Kablllo HDMI-HDMI 1.5m	cope	2.0		
5	F.V.Kablllo HDMI-HDMI 3m	cope	2.0		
6	F.V.Kablllo DP-DP	cope	2.0		
7	F.V.Konvertues HDMI-DP	cope	2.0		
8	F.V.Perde për projektion	cope	1.0		
9	F.V Sistem mbajtëse për perden (Truss)	cope	1.0		
	SISTEMI AUDIO I SALLES				
10	F.V.Boks MODEL 1	cope	2.0		
11	F.V.Boks MODEL 2	cope	2.0		
12	F.V. Boks MODEL 3	cope	1.0		
13	F.V. Amplifikator Fuqie	cope	1.0		
14	F.V.Strukturë mbajtëse për bokset.	cope	4.0		
15	F.V.Kablllo sinjali Audio	ml	200.0		
16	F.V.Konektor Audio (SpeakON)	copë	10.0		
17	F.V.Mikrofon Valor	copë	2.0		
18	F.V.Mikrofon me kablllo	copë	2.0		
19	F.V.Rack 12U	copë	1.0		
20	F.V. Soft për konfigurimin e amplifikatorit të sistemit audio.	copë	1.0		
21	F.V. Mixer Audio	cope	1.0		
	SISTEMI REGJISTRUES VIDEO				
22	F.V. Kamer PTZ	copë	1.0		
23	F.V. NVR	copë	1.0		
24	F.V. HDD 1TB	copë	1.0		
25	F.V. Kablllo dhe konektor për lidhjen e kamerës	set	1.0		
26	F.V. Workstation i kompletuar	copë	1.0		

Afatet e l vrimitt: BRENDA 60 DITEVE NGA DATA E LIDHJES SE KONTRATES

Artikulli	P�rshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dor�zimit

Shtojca 8.

[Shtojc  p r t'  plot suar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE T  P RZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E P RGJITHSHME T  P RZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së perlllogaritur e kontratës, që

prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.3 Nëse OE nuk është vete prodhues apo distributor i autorizuar i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar ku OE autorizohet specifikisht për pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi. Mallrat / produktet për të cilat OE duhet minimalisht të ketë autorizimin e prodhuesit / distributorit të autorizuar janë: pajisja e zërit 2 të preventivit (Video Projektor Profesional); pajisjet e zëreve 10, 11, 12, 13 të preventivit (Bokse Tipi 1, 2, 3 dhe amplifikator fuqie).

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit / distributorit: emërtimi i kompanisë, adresa, të dhënat fiskale, telefon, e-mail, me qëllim që në rast nevojë Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë vërtetësinë e të dhënave të paraqitura nga OE në procedurën e prokurimit.

2.3.4 Garancia e pajisjeve dhe materialeve do të jetë të paktën një (1) vit nga data e marrjes në dorezim nga Autoriteti Kontraktor, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin / zëvendësimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit ose instalimit.

2.3.5 Operatori ekonomik për të garantuar realizimin e objektit të prokurimit duhet të paraqesë certifikatat për standardet ISO si më poshtë:

* ISO 9001:2015 ose ekuivalente (për menaxhimin e sistemit të cilësisë) ku të certifikohen kapacitetet e OE në fushën e objektit të prokurimit.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë.

2.3.6 Për të vërtetuar përputhshmerinë me specifikimet teknike të kërkuara, OE duhet të paraqesë Skedat teknike (datasheet) për mallrat që përfshihen në specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
